



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.337/6 prot.

Datë 08.04.2022

**V E N D I M**

**Nr. 331/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2N” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr.REF-16669-12-29-2021, me objekt “Rikonstruksion dhe sistemin asfaltimi i rrugës SHISH-Unaze, Bashkia Dibër 2021”, me fond limit 15,055,373 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 21-01-2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
- Ankimues:** “2N” SHPK  
Lagjja Paskuqan Fushe, Rruga Demokracia, Pll.2, K.1 Paskuqan
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Dibër  
Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.12.2021, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr.REF-16669-12-29-2021, me objekt “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltimi i rrugës SHISH-Unaze, Bashkia Dibër 2021”, me fond limit 15,055,373 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 21-01-2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 21.01.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 08.02.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- SMO Union	9,913,770	I skualifikuar
- Shkëlqimi 07	10,000,000	I skualifikuar
- 2N	11,997,488	I skualifikuar
- Denis 05	12,631,105	I skualifikuar
- Kupa	13,844,892	I skualifikuar
- Selami	14,455,130	I skualifikuar

II.4. Në datën 08.02.2022 operatori ekonomik “2N” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Operatori Ekonomik 2N nuk ka paraqitur dokumente provuese për furnizimin e tij me Prodhime asfalti ne kantiere te posacme ne pronesi ose me qira.*
- *Ne listen e çmimeve kemi konstatuar gabime aritmetike dhe*
- *nuk ka paraqitur dokumente provues per te vertetuar stafin teknik dhe inxhenerik te deklaruar ne shtojcen 8 si kontrata deshmi profesionale dhe sigurimin teknik ne Pune te kerkuara keto ne shtojcen 1 me date 11.01.2022.*
- *Ndaj rrjedhimisht oferta juaj Skualifikohet.*

II.5. Në datën 16.02.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 18.02.2022 operatori ekonomik “2N” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor, me pretendimet si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se shoqëria 2N ShPK e disponon fabrikën e asfalto betonit të pajisur me leje mjedisore nëpërmjet kontratës së qirasë lidhur mes palëve më datë 10.01.2022. Sendi I cili është objekt kontrate është i ligjshëm dhe brenda qarkullimit civil të sendeve të lejuara në RSH. Kjo kontratë i është bërë me dije AK nëpërmjet plotësimit të pikës C të shtojcës 8 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit dhe nëpërmjet SPE ku kontrata e qerasë bashkë me dokumentacionin përkatës është ngarkuar në sistem.*
- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se shoqëria 2N ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit dokumentin me emërtimin Formulari i Ofertës Ekonomike i cili përmban shtojcën 1 dhe shtojcën 2 të plotësuar. AK ka përllogaritur dhe publikuar vlerën e ofertës ekonomike të OE 2N ShPK me gabime aritmetike me një diferencë në shumën 10,000,000 lekë pa TVSh më e ulët se ajo që 2N ShPK ka ofertuar realisht. Nuk jemi para faktit të parashikuar në nenin 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 sepse në ofertën e shoqërisë 2N ShPK nuk ekzistojnë gabime mbi 2 % të vlerës së ofertuar dhe as nën 2 % të vlerës së ofertuar. Në rastin e situatës së fundit përsëri AK ka qenë i detyruar të njoftojë operatorin ekonomik për korrigjimin e ofertës por një kërkesë e tillë nga AK nuk ekziston. Kërkojmë nga AK ndryshimin dhe saktësimin e vlerës së ofruar nga OE 2N ShPK në vlerën 11,997,488 lekë pa TVSh.*
- *Lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit sqarojmë se në pikën 2.3.2 dhe pikën 2.3.4 AK nëpërmjet shtojcës nr.1 datë 11.01.2022 ka shtuar paragrafin i cili parashikon momentin e dorëzimit të dokumentacionit të deklaruar në shtojcën 8 Formulari I vetëdeklarimit. AK nuk ka kërkuar nëpërmjet ndonjë shkrese zyrtare dhe as nuk e ka vënë në dijeni shoqërinë 2N nëpërmjet mënyrave të njohura nga ligji për të dorëzuar dokumentacionin provues të cilat janë deklaruar nga shoqëria 2N ShPK në SPE.*

*Shoqëria 2N ka qenë e gatshme për të plotësuar çdo detyrim ligjor që mund ti vinte si pasojë e kërkesës së AK. Por në rastin konkret kemi mosveprim të AK.*

- *Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.337/2 prot datë 21.02.2022 me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën nr.765 prot, datë 15.03.2022, protokolluar me tonën me nr.337/4 datë 16.03.2022 me lëndë “kërkesë për informacion”, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik konsulencë në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik 2N ShPK, nëse duhet të merret në shqyrtim nga ana e Bashkisë Dibër?Referuar parashtrimeve në shkresën e sipërcituar autoriteti kontraktor pretendon, se ankesa e operatorit ekonomik 2N ShPK është paraqitur jashtë afateve të lejuara ligjore duke marrë në konsideratë datën e njoftimit të klasifikimit.

II.9. Me shkresën nr. 528/2 prot datë 24.03.2022 protokolluar me tonën me nr.337/5 datë 28.03.2022 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues 2N ShPK, ku rezulton të jetë vendosur pranimi pjesërisht i ankesës me argumentet si më poshtë:

- *Për sa i përket pikës 2.3.2. të dokumenteve të tenderit operatori ekonomik nuk duhet të paraqesë dokumente mbështetëse për plotësimin e kësaj pike të DT sepse dokumentet provuese për vetëdeklarimet paraqiten nga OE I kualifikuar në radhë të parë para njoftim fituesit. Pretendimi i OE qëndron.*
- *Lidhur me arsyen e skualifikimit në listën e çmimeve kemi konstatuar gabime aritmetike , operatori ekonomik ka gabime aritmetike ku të cilat nuk e kalojnë vlerën 2% të vlerës totale të ofertës dhe në rastin konkret nuk përbën shkak për skualifikim. Pretendimi i OE qëndron.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “2N” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentet se “Ne listën e çmimeve kemi konstatuar gabime aritmetike; dhe nuk ka paraqitur dokumente provues për të vërtetuar stafin teknik dhe inxhenerik të deklaruar

*në shtojcën 8 si kontrata dëshmi profesionale dhe sigurimin teknik në punë të kërkuara këto në shtojcën 1 më datë 11.01.2022, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Me shkresën nr.765 prot, datë 15.03.2022, protokolluar me tonën me nr.337/4 datë 16.03.2022 me lëndë “kërkesë për informacion”, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik konsulencë në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik 2N ShPK, nëse duhet të merret në shqyrtim nga ana e Bashkisë Dibër? Referuar parashtrimeve në shkresën e sipërcituar, autoriteti kontraktor pretendon, se ankesa e operatorit ekonomik 2N ShPK është paraqitur jashtë afateve të lejuara ligjore duke marrë në konsideratë datën e njoftimit të klasifikimit.

III.1.2. Me shkresën nr. 528/2 prot datë 24.03.2022 protokolluar me tonën me nr.337/5 datë 28.03.2022 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues 2N ShPK, ku rezulton të jetë vendosur pranimi pjesërisht i ankesës me argumentet si më poshtë:

- *Për sa i përket pikës 2.3.2. të dokumenteve të tenderit operatori ekonomik nuk duhet të paraqesë dokumente mbështetëse për plotësimin e kësaj pike të DT sepse dokumentet provuese për vetëdeklarimet paraqiten nga OE i kualifikuar në radhë të parë para njoftim fituesit. Pretendimi i OE qëndron.*
- *Lidhur me arsyen e skualifikimit në listën e çmimeve kemi konstatuar gabime aritmetike , operatori ekonomik ka gabime aritmetike ku të cilat nuk e kalojnë vlerën 2% të vlerës totale të ofertës dhe në rastin konkret nuk përbën shkak për skualifikim. Pretendimi i OE qëndron.*

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*  
*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.5. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret autoriteti kontraktor ka keqinterpretuar dispozitat ligjore në fuqi lidhur me afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë, si dhe lidhur me afatet e shqyrtimit të ankesës. Ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” e konkretisht nenit 110 pika 1 dhe 2 parashikon shprehimisht se: 1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Ndërsa neni 114 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.6. Në interpretim literal të dispozitave ligjore të sipërcituara, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar drejt parashikimet e reja ligjore në lidhje me afatet e ankimimit të operatorëve ekonomikë, si dhe në lidhje me afatet e trajtimit të ankesës së operatorëve ekonomikë nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht, KPP gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor, se ankesa e operatorit ekonomik 2N ShPK është paraqitur jashtë afateve të lejuara ligjore duke marrë si reference datën e klasifikimit të ofertave është e pabazuar në ligj. KPP gjykon se ankesa e operatorit ekonomik ankimues 2N ShPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 110 pika 2 e LPP-së. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi afati i ankimit për operatorët ekonomikë në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, është brenda 10 ditëve nga **publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.** Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. Në rastin konkret për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, publikimi i njoftimit të anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike është bërë nga ana e autoritetit kontraktor në datë 16.02.2022. KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik 2N ShPK është dorëzuar pranë KPP më datë 18.02.2022 ndërsa referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.528/2 prot datë 24.03.2022 ankesa pranë autoritetit kontraktor është dorëzuar më datë 21.02.2022, brenda afatit 7 ditor të parashikuar nga dispozita ligjore e sipërcituar. Ndërkohë KPP, vëren se akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor mban datën 23.03.2022, gati një muaj nga data e paraqitjes së ankesës. Në këto kushte, KPP e gjen ankesën e operatorit ekonomik të dorëzuar në përputhje me përcaktimet ligjore ndërsa e gjen në tejkalim të afateve ligjore aktin e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mosveprimi i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës brenda afateve ligjore përbën shkelje procedurale. Autoriteti kontraktor në rastin konkret nuk ka respektuar nenin 114 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre”. KPP konstaton, se në procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk ka pasur asnjë operator ekonomik të interesuar, për faktin se në procedurën e prokurimit nuk ka pasur ofertues të kualifikuar dhe procedura e prokurimit është anuluar nga autoriteti kontraktor. Në këto rrethana, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhej të trajtonte ankesën e operatorit ekonomik 2N ShPK brenda 5 ditëve nga data e dorëzimit të saj. KPP gjen me vend të nënvizojë se *ratio legis* e trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, brenda afateve të përcaktuara ligjore, krahas parimit të efikasitetit dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, lidhet ngushtësisht me momentin procedural të lindjes së të drejtës së Komisionit të

Prokurimit Publik për të shqyrtuar ankesën dhe nxjerrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen. Sipas përcaktimeve ligjore, KPP shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- iii. b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- iv. c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

III.1.7. Referuar sa më lart, KPP tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me afatet e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues 2N ShPK. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Ndërsa sa i takon vijimit të shqyrtimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, ky i fundit duke pasur parasysh që në rastin konkret mosshqyrtimi i ankesës brenda afateve të lejuara ligjore nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka pasur ndikim tek operatorë të tjerë të interesuar pjesëmarrës në procedurë, gjykon të marrë në konsideratë përfundimet e aktit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues në të cilin është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës lidhur me dy nga arsyet e skualifikimit. Në këtë kuptim, KPP gjykon se për 2 arsyet e skualifikimit: 1. *Ne listën e çmimeve kemi konstatuar gabime aritmetike; dhe 2. nuk ka paraqitur dokumente provues për të vërtetuar stafin teknik dhe inxhenerik të deklaruar në shtojcën 8 si kontrata dëshmi profesionale dhe sigurimin teknik në punë të kërkuara këto ne shtojcën 1 më datë 11.01.2022, çështja do të mbyllet në zbatim të nenit 115 pika 2 e LPP-së ku parashikohet se: Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

III.1.8. Ndërkohë po në përputhje me parashikimet ligjore sa më sipër, KPP gjykon të vazhdojë procedurën për pjesën tjetër sa i takon arsyes së skualifikimit *Operatori Ekonomik 2N nuk ka paraqitur dokumente provuese për furnizimin e tij me Prodhime asfalti në kantiere të posaçme në pronësi ose me qira*, e cila referuar aktit të trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor nuk është pranuar.

III.1.9. Konkretisht lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues 2N ShPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit *“Operatori Ekonomik 2N nuk ka paraqitur dokumente provuese për furnizimin e tij me Prodhime asfalti në kantiere të posaçme në pronësi ose me qira”* Komisioni vëren se,



III.1.10. Në shtojcën 1 “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.7** *Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):*

6	<i>Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore</i>	<i>Në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
---	---	--	---------------

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- b) Për mjetet e siguruara me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerases, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*  
*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

III.1.11. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni vëren, se operatori ekonomik ankimes 2N ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Kontratë Qiraje Nr.132 rep nr.69 Kol datë 10.01.2022 lidhur ndërmjet Shoqërisë A Klas Beton Asfalt dhe shoqërisë 2N ShPK me objekt ndër të tjera: Fabrikë Asfaltbetoni me vendndodhje në Shënkoll, Gajush, Fshati Gajush, Lezhë dhe Leje Mjedisore nr. Identifikimi 1598 datë 25.04.2014 e përvetësuar nga kontrata e shitjes nr.8111 rep dhe nr.9765 kol datë 18.12.2008. (bashkëngjitur kontrata).

- Leje mjedisore e tipit B për impiant të asfaltit dhe të betonit me kod III.1.B në emër të subjektit A-Klas -Beton Asfalt.
- Foto të impiantit

III.1.12. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

d) *mjetet e pajisjet teknike*, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”.

5. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.13. KPP gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.14. Referuar sa më sipër, KPP konstaton, se në kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike ndër të tjera disponimin e një Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore. Format e disponimit të fabrikës së asfalto-betonit sipas përcaktimeve në kriter mund të jetë në pronësi, me qira ose me kontratë furnizimi. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "2N" SHPK, ka provuar disponimin e Fabrikës së asfalto-betonit nëpërmjet kontratës së qirase Nr.132 rep nr.69 Kol datë 10.01.2022 lidhur ndërmjet Shoqërisë A Klas Beton Asfalt dhe shoqërisë 2N ShPK. Gjithashtu, në përputhje me kërkesën në kriter ankimuesi ka dorëzuar edhe dokumentin Leje mjedisore e tipit B për impiant të asfaltit dhe të betonit me kod III.1.B në emër të subjektit A-Klas -Beton Asfalt (qiradhënësit). Në rastin konkret KPP gjykon, se operatori ekonomik 2N ShPK me dokumentacionin e dorëzuar dëshmon, se disponon kapacitetet teknike lidhur me një Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore, në formën e parashikuar në kriterin e veçantë të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP gjykon, se argumentet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave se: *në kontratën e qirasë përshkruhet se mjetet e marra me qira janë pasuri e luajtshme. Duke qenë se operatori ekonomik 2N ShPK ka marrë me qira mjetet për ndërtimin e fabrikës së asfaltobetonit, ai duhet të disponojë dhe lejen mjedisore për ushtrimin e aktivitetit, janë të pabazuara dhe në tejkalim të kërkesave të vendosura në kriter nga vetë autoriteti kontraktor. KPP gjykon, se vetë autoriteti kontraktor ka lejuar disponimin e Fabrikës së asfalto-betonit nëpërmjet kontratës së qirasë ose kontratës së furnizimit. Akoma më tej vetë autoriteti kontraktor ka kërkuar, se për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre. Në rastin konkret ankimuesi ka provuar kapacitetin teknik të kërkuar nëpërmjet kontratës së qirasë, duke dorëzuar kështu dokumentacionin që vërteton marrjen me qira të tij, e për pasojë edhe dokumentacioni shoqërues që lidhet me këtë kapacitet i takon palës qiradhënëse sikundër leja mjedisore në emër të subjektit që e disponon në pronësi A-Klas -Beton Asfalt. Në këtë kuptim, KPP e gjen arsyen e skualifikimit të ankimuesit të pabazuar dhe gjykon se ankimuesi ka përmbushur kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit duke dorëzuar kontratën e qirasë për fabrikën e asfaltit dhe betonit, si dhe bashkë me të edhe*

dokumentacionin e disponuar nga pronari i fabrikës së asfaltit, sikundër leja mjedisore me kodin III.1.B. Në përfundim Komisioni, gjykon, se operatori ekonomik 2N SHPK është në kushtet e përmbushjes së kriterit të veçantë të kualifikimit dhe rrjedhimisht dokumentacioni i tij konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “2N” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr.REF-16669-12-29-2021, me objekt “Rikonstruksion dhe sistemim asfaltimi i rrugës SHISH-Unaze, Bashkia Dibër 2021”, me fond limit 15,055,373 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 21-01-2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “2N” SHPK për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “2N” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2N” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**